

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Isa Boletini 39

Qyteti: PRISHTINË

Kodi Postar: 10000

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Sa i përket tenderit **Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

NOVAMAT shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Ismali Qemali" Pallati Samos Tower, Kati i 8të, Nr. 41,

(Adresa)

Tirana

1001

(Vendi)

+355 44 505 180

(Kodi postar)

n/a

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mehmet KRASNIQI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@novamat.al

(Adresa elektronike)

27.02.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Isa Boletini 39

Qyteti: PRISHTINË

Kodi Postar: 10000

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Sa i përket tenderit **Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

NOVAMAT shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Ismali Qemali" Pallati Samos Tower, Kati i 8të, Nr. 41,

(Adresa)

Tirana

1001

(Vendi)

+355 44 505 180

(Kodi postar)

n/a

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mehmet KRASNIQI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@novamat.al

(Adresa elektronike)

27.02.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

*Shpallja e tenderit është bërë më datë **06.12.2024**, ndërsa data e dorëzimit të ofertave dhe hapjes së tyre ka qenë **27.12.2024** ora 13:00, kriteri i dhënies së kontratës ka qenë çmimi më i ulët.*

*Më datën **07.02.2025**, **NOVAMAT shpk**, pranon një letër standarde për tenderuesin e eliminuar.*

*Më datën **07.02.2025**, **NOVAMAT shpk**, pranon Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues.*

*Më datën **10.02.2025**, **NOVAMAT shpk** i aprovohet kërkesa për qasje në dokumentacion*

*Më datën **11.02.2025**, **NOVAMAT shpk** paraqet Kërkesën për Rishqyrtim sipas LPP-së*

*Më datën **12.02.2025**, **NOVAMAT shpk**, pranon Njoftimin mbi Pezullimin e procedurës së prokurimit sipas nenit 108 të LPP-së.*

*Më datën **19.02.2025**, **NOVAMAT shpk**, pranon Vendimin për shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim sipas nenit 108 të LPP-se.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik (Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 i datës 21 Janar 2016) dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

NOVAMAT shpk pretendon se **AK** i ka shkelur këto dispozita të LPP - (Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Indryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092) dhe të Rregullores 001.2022 për Prokurimin Publik

Neni 1 Qëllimi

OE NOVAMAT SH.P.K pretendon dhe e konsideron se **AK** me rastin e eliminimit tonë nga tenderimi dhe anulimit të tenderit **“Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2”** ka shkelur paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-se, ku theksohet si në vijim :

1. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

AK ka dështuar që ta përmbushë këtë paragraf për të siguruar zbatimin e obligimit në shpenzimet e fondeve publike , garantimin e zbatimit të rregullave procedurale sipas këtij ligji dhe ruajtjen e të drejtave për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e Prokurimit në fjalë.

Faktet që ne do i paraqesim në vijim, lidhur me shkeljet e dispozitave konkrete të LPP-së nga AK , e tregojnë më së miri se “B58-Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” i AK për “Rezultati i aktivitetit të prokurimit” Oper. Sistemi, Trans.dhe Tregu – KOSTT SH.A pas vlerësimit të tenderëve e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se tenderët e dorëzuar nuk janë të përgjegjshëm. Është në kundërshtim me Qëllimin e këtij ligji.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

AK me rastin e shqyrtimit të dosjes së tenderit të dorëzuar nga OE NOVAMAT SH.P.K ka qenë i obliguar që ta sigurojë shqyrtimin e ofertës të OE NOVAMAT SH.P.K në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, i cili e thekson si në vijim :

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

AK nuk e ka përmbushur këtë dispozitë pasi që ka vendosur ta Anulojë Aktivitetin e Prokurimit pa i shfrytëzuar në mënyrë adekuate mundësitë ligjore të parapara me dispozita të LPP-së për shpërblimin me kontratë OE NOVAMAT SH.P.K.

Një veprim i tillë e dëmton buxhetin e RKS pasi që oferta jonë është më e lira dhe njëherë plotëson kushtin e kriterëve për dhënien e kontratës – çmimi më i ulët , gjithashtu edhe në arritjen e objektivave në realizimin e projekteve vitale me interes shoqëror, social dhe institucional.

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Në rastin konkret shihet se AK ofertën e OE NOVAMAT SH.P.K e ka trajtuar në kundërshtim me nenin 7 respektivisht duke i mos aplikuar nenet e paraqitura në shkresë. AK me rastin e eliminimit të ofertës sonë nga tenderimi dhe anulimit të tenderit **“Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2”** ka shkelur në mënyrë flagrante të gjithë paragrafët e nenit 7 të LPP-se.

Lehtësisht vërtetohet ky konstatim i joni , vetëm nëse analizohet dhe krahasohet me nenin 7 të LPP-se arsyetimi i eliminimit të ofertës së OE NOVAMAT SH.P.K në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar e cila e thekson si në vijim

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- **Autoriteti Kontraktues në bazë të specifikimit teknik ka kërkuar që pajisja të jetë e tipit “Kelman Transport X²”, ndërsa ju keni ofertuar me pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”, e cila nuk i përgjigjet specifikimit teknik.**

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Autoriteti Kontraktues në bazë të specifikimit teknik ka kërkuar që pajisja të jetë e tipit “Kelman Transport X²”, ndërsa ju keni ofertuar me pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”, e cila nuk i përgjigjet specifikimit teknik.

Neni 7 i LPP-se e thekson si në vijim :

1. Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të

përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

AK ka bërë shkeljen e këtij paragrafi me faktin që ka eliminuar ofertën tonë të ofertuar sipas specifikave teknike të Dosjes së Tenderit por me produkte të emërtuar ndryshe pasi që prodhohen nga firma/ brand të ndryshme, shihet si në vijim :

Kompanitë që i prodhojnë këto pajisje janë:

- **Kelman Transport X² është një produkt i GE Grid Solutions, që është pjesë e General Electric (GE).**
- **Hydrocal 1011 genX P është një produkt i EMH Energie-Messtechnik GmbH, një kompani Gjermane.**

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Sic konstatohet AK ka dështuar ta aplikojë nenin 7 të LPP-se me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertës së OE NOVAMAT SH.P.K në tenderin “Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2.”

Neni 56
Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
 - 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

AK me Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” i AK për “Rezultati i aktivitetit të prokurimit” Oper. Sistemi, Trans.dhe Tregu – KOSTT SH.A pas vlerësimit të tenderëve e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se tenderët e dorëzuar nuk janë të përgjegjshëm, respektivisht letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar - duke e eliminuar ofertën e OE NOVAMAT SH.P.K duke e theksuar se Autoriteti Kontraktues në bazë të specifikimit teknik ka kërkuar që pajisja të jetë e tipit “Kelman Transport X²”, ndërsa ju keni ofertuar me pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”, e cila nuk i përgjigjet specifikimit teknik. ËSHTË bërë shkelje e paragrafit 1.1 të nenit 56 të LPP-së. Këtë konstatim e bazojmë në faktin se në pikën II 1.5 të njoftimit për kontratë theksohet si në vijim :

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, ndërsa

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) Sipas specifikimit teknik.

Nëse shikohet Dosja e tenderit në specifikimin teknik pika 2.1 ku i paraqet të dhënat teknike të pajisjes e thekson si në vijim :

2.1 Të dhënat teknike të pajisjes

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur parametrat kryesorë teknikë të pajisjes së kërkuar përmes këtij specifikimi, të cilat tregojnë performancën dhe kapacitetin e saj për analizën e gazrave të tretur dhe lagështisë në vajin e transformatorit.

Parametri	Kërkesa	Oferta
Tensioni i furnizimit AC	230 [V] AC	
Frekuenca	50 [Hz]	
Fuqia	40 [W]	
Kutia transportuese	Kuti e fortë plastike	
Mbrojtja	IP67 (kur është e mbyllur) IP20 (kur është duke operuar)	
Vëllimi i mostres së vajit	50 [ml]	
Vëllimi i mostres së gazit	5 [ml] (Buchholz Gas)	

Temperatura e operimit	+5°C deri në +50 °C	
Nxjerrja e matjeve	USB; hardcopy	
Kapaciteti i ruajtjes së matjeve	>20,000 matje	
Diagnostifikimet	Duval's triangle, Roger's ratio, Key Gas & Japanese ETRA	
Madhësia e ekranit	6.5inch (colour touchscreen)	
Pesha	9 [kg]	
Gjuha e pajisjes	English	

Andaj AK ka qenë i obliguar që me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertës së OE NOVAMAT SH.P.K ta vërtetojë nëse produkti i ofertuar “*Hydrocal 1011 genX P*” e plotëson specifikimin teknik të paraparë në [Dosjen e tenderit në pjesën specifikimin teknik pika 2.1 ku i paraqet të dhënat teknike të pajisjes](#). Respektivisht lehtësisht konstatohet se pajisja Hydrocal 1011 genX P i plotëson kriteret dhe kushtet teknike të paraqitura më sipër, madje në shumë parametra dhe specifikime teknike madje edhe i tejkalon kërkesat e AK- së.

NË KËTË KUADËR TË ANALIZËS TEKNIKE TË OFERTËS DOREZUAR NGA ANA JONË, BËJMË ME DIJE:

Në respektim të së drejtës që parasheh LPP, i jemi drejtuar AK- së me Kërkesë për qasje në dokumtacionin e dorëzuar nga konkurenca, nga e cila është konstatuar se: Modeli i ofruar prej grupit të OE “ELPROJEKT SHPK”& ITS GROUP SHPK është pajisja “KELMAN Transport X2”.

Në analizën teknike të dokumentacionit dorëzuar nga ky grup i O.E, konstatohet se skeda teknike e prodhuesit, saktësisht dokumenti në pdf “GE Kelman Transport X2 DGA Tech Data Sheet” paraqet karakteristikat teknike të produktit të ofruar (që njëkohësisht është edhe produkti i kërkuar nga AK në DST).

Kështu nga ky specifikim konstatohet se:

Diapazoni i dedektimeve të matjeve të kësaj pajisje (Measurements Range) është si më poshtë:

(screenshot shkëputur nga materiali në pdf “GE Kelman Transport X2 DGA Tech Data Sheet”)

Technical Specification

MEASUREMENT RANGE

Hydrogen (H ₂)	5 – 5,000 ppm
Carbon Monoxide (CO)	2 – 50,000 ppm
Carbon Dioxide (CO ₂)	40 – 50,000 ppm
Methane (CH ₄)	2 - 50,000 ppm
Acetylene (C ₂ H ₂)	0.5 - 50,000 ppm
Ethane (C ₂ H ₆)	2 - 50,000 ppm
Ethylene (C ₂ H ₄)	2 - 50,000 ppm

Por, theksojme këtu se:

Sikurse është dëshmuar edhe përmes specifikimit teknik dorëzuar nga ana jonë për pajisjen “Hydrocal 1011 genX P” (shiko dokumentin “Specifikimi Teknik, Manuali HYDROCAL 1011 genX P” dorëzuar nga ana jonë në fazë tenderimi) pajisja që i kemi propozuar ne AK- së ofron një gamë të dedektimit të matjeve edhe më të gjerë, saktësisht:

Measurement

Measuring Quantity	Measuring Range	Accuracy of gas extraction	Accuracy of the gas measurement
Hydrogen H ₂	0 ... 10000 ppm	≤ ± 8 % ± 4 ppm	≤ ± 10 % ± 20 ppm
Carbon Monoxide CO	0 ... 10000 ppm	≤ ± 8 % ± 30 ppm	≤ ± 10 % ± 5 ppm
Carbon Dioxide CO ₂	0 ... 20000 ppm	≤ ± 8 % ± 30 ppm	≤ ± 10 % ± 5 ppm
Methane CH ₄	0 ... 10000 ppm	≤ ± 8 % ± 4 ppm	≤ ± 10 % ± 5 ppm
Acetylene C ₂ H ₂	0 ... 10000 ppm	≤ ± 8 % ± 4 ppm	≤ ± 10 % ± 5 ppm
Ethylene C ₂ H ₄	0 ... 10000 ppm	≤ ± 8 % ± 4 ppm	≤ ± 10 % ± 5 ppm
Ethane C ₂ H ₆	0 ... 10000 ppm	≤ ± 8 % ± 4 ppm	≤ ± 10 % ± 5 ppm
Propane C ₃ H ₈	0 ... 5000 ppm	≤ ± 8 % ± 4 ppm	≤ ± 15 % ± 20 ppm
Oxygen O ₂	0 ... 50000 ppm	≤ ± 8 % ± 500 ppm	≤ ± 10 % ± 500 ppm
Nitrogen N ₂	0 ... 150000 ppm	≤ ± 8 % ± 1500 ppm	≤ ± 10 % ± 1500 ppm

Oil moisture measurement

Measuring Quantity	Measuring Range	Accuracy of oil moisture measurement
Moisture in Oil H ₂ O	0 ... 100 % 0 ... 150 ppm 0 ... 2000 ppm	≤ ± 3 % (absolut) ≤ ± 3 % ± 3 ppm ≤ ± 3 % of MSC ¹⁾

Nga sa më sipër, sikurse edhe konstatohet produkti i ofertuar nga ne përmbush dhe tejkalon kërkesat e AK- së.

Me tej, në analizë teknike, konstatohet se:

Pajisja “KELMAN Transport X2” ofron mundësinë e operimit në temperaturë ambienti “5 – 50 °C”(shiko screenshot më poshtë)

ENVIRONMENT

Operating Ambient

5 – 50 °C (+41 to +122 °F)

Temperature

Ndërsa, pajisja e ofertuar nga ne, sikurse shihet edhe në skedën teknike dorëzuar nga ne në fazë tenderimi, ofron mundësinë e operimit në temperaturë ambienti “-10 – 50 °C” (shiko screenshot më poshtë) , kjo duke patur në konsideratë faktin se temperaturat në shtetin e Kosovës vazhdimisht kapin vlerat nën zero.

Technical data HYDROCAL 1011 *genX* P

General

Power supply:	88 VAC _{min} ... 264 VAC _{max} 47 ... 63 Hz
24 VDC supply:	20 VDC _{min} ... 28 VDC _{max}
Power consumption:	max. 130 W
Housing:	Hard plastic housing
Dimensions:	W 447 x D 297 x H 187 mm
Weight:	approx. 13.4 kg
Operation temperature: (ambient)	-10°C ... +50°C

Po ashtu nga krahasimi teknik mes pajisjes të ofertuar nga ne “Hydrocal 1011 genX P” dhe pajisjes “KELMAN Transport X2” të ofertuar nga konkurenca (produkt që AK i referohet po ashtu në kërkesën e tij në DST), vërehet se:

Pjesë e specifikimit teknik të “KELMAN Transport X2” përshkruhet si avantazh fakti se pajisja ofron mundësinë e matjeve/ realizimit të analizës së plotë cdo 30 min. Shiko screenshot më poshtë:

Key Benefits

- Measurement of seven diagnostic gases and moisture content in the oil
- Fast diagnostics in less than 30 minutes
- Intuitive touchscreen interface with step-by-step instructions and Plug and Play connectivity
- Compatible with mineral insulating oils and newer ester-based fluids (natural and synthetic)
- Enables operators to effectively respond to alarms, trip events and supports on-site field decision making
- Ideal companion to GE's range of single gas online DGA monitors for adding transformer diagnostics

Por theksohet këtu se:

Këtë mundësi të matjes kjo pajisje e ofron vetëm për 7 gazra, duke mos përfshirë këtu matjen e gazrave të tillë si: Oksigjen (O₂), Nitrogjen(N₂) dhe Propen (C₃H₆) (gazra këto të cilat mbulohen në procesin e analizës së plotë brenda 1 ore për të gjithë gazrat së bashku në pajisjen e ofertuar nga ne HYDROCAL.

Më tej:

Sikurse e kemi dëshmuar edhe përmes Tabelës teknike të ofertuar nga ne në fazë tenderimi, mostra e pajisjes “HYDROCAL” është një shiringë qelqi 100 ml.

Kjo në analizë të parë mund të mos konsiderohet një avantazh domethenes, por duke patur në konsiderate faktin se metoda e grumbullimit / marrjes se vajit eshte shume me e rendesishme me qellim marrjen e nje rezultati sa me real/ te vertete dhe te pagabueshem te perqendrimit te gazit, ne kete kuader shiringa e qelqit me kapacitet 100ml perben nje avantazh te dukshem ne procesin e punes.

Nje avantazh tjeter po kaq i rendesishem qe duhet theksuar sa i takoj pajisjes HYDROCAL 1011 genX P ofertuar nga ne eshte fakti se kjo pajisje ka memorie

standarde 1 GB të bazuar në kartën SD, e cila mund të ruajë më shumë se 20000 regjistrime matjeje, avantazh tepër i rendesishëm ky i cili mungon në pajisjen **KELMAN**.

Pajisja ka printer termik të integruar, për të printuar rezultatet menjëherë pas matjes pa përdorur asnjë kompjuter ose softuer. Softueri MTE HydroSOFT Hybrid App bazohet në SQLServer për të ruajtur më shumë se 20000 informacione të transformatorëve së bashku me rezultatet DGA dhe gjithashtu monitorimin në kohe reale të rezultateve të DGA.

Shiko screenshot me poshte shkeputur nga specifikimi teknik i produktit te ofertuar nga ne:

Key Advantages

- Individual measurement of hydrogen (H₂), carbon monoxide (CO), carbon dioxide (CO₂), methane (CH₄), acetylene (C₂H₂), ethylene (C₂H₄), ethane (C₂H₆), oxygen (O₂), nitrogen (N₂) and propane (C₃H₈)
- Moisture in oil (H₂O) measurement
- Maintenance-free near infrared measurement system with head-space gas extraction acc. IEC 60567
- Operation by integrated 7" color TFT (800x480 pixel) touch-screen or via genX webserver from any smart phone, notepad or PC
- Communication interfaces WiFi, USB or ETHERNET 10/100 Mbit/s
- SD memory of test results, history and diagnostic data of power transformers and oil-filled electrical equipment
- Integrated thermal report printer
- Optional Battery Pack for up to 10 measurements and Automotive Supply 12 VDC to 24 VDC

Po ashtu, deshmohet ketu edhe nje avantazh tjeter i madh i kesaj pajise: Menyra e komunikimit e cila ofron teknologji shume me te avancuar krahasuar me pajisjen “**KELMAN Transport X2**”.

Pajisja HYDROCAL 1011 genX P i mundeson perdoruesit komunikimin permes ETHERNET 10/100 Mbit/s copper-wired (RJ 45); WLAN / WiFi ; USB Type B.

Technical data HYDROCAL 1011 *genX P*

General

Power supply:	88 VAC _{min} ... 264 VAC _{max} 47 ... 63 Hz
24 VDC supply:	20 VDC _{min} ... 28 VDC _{max}
Power consumption:	max. 130 W
Housing:	Hard plastic housing
Dimensions:	W 447 x D 297 x H 187 mm
Weight:	approx. 13.4 kg
Operation temperature: (ambient)	-10°C ... +50°C
Oil temperature: (in the transformer)	-20°C ... +90°C
Storage temperature: (ambient)	-20°C ... +60°C

Me rendesi te theksohet eshte edhe fakti se:

Sikurse edhe deshmohet ne skeden teknike dorezuar nga ana jone per pajisjen e ofruar HYDROCAL 1011 genX P, sistemi/procesi i marrjes së mostrave të njësisë HYDROCAL 1011 genX P është shumë i thjeshtë, më funksionale dhe më e qëndrueshme dhe nuk kërkon asnjë tub ose tubacion të jashtëm/të dukshëm, gjë që ka gjithmonë rrezik për dështime/probleme. Mbulesa e mbylljes së kontejnerit është prej aliazh metali, jo plastike, duke i dhene keshtu pajijses nje avantazh te dukshem.

Me rastin e mos shpalljes se fitues te tenderit Ofertën e OE NOVAMAT SH.P.K, AK ka shkelur edhe paragrafin 1.2 te nenit 56 dhe paragrafin 1.1 te nenit 60 te LPP-se te cilët e theksojnë si ne vijim:

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Paragrafi 1.1 i nenit 60 : 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Oferta e OE NOVAMAT SH.P.K për tenderin Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, ka pasur çmimin me te ulet ne krahasim me ofertën e OE tjetër te dorëzuar ne vlerën prej 66,740.80 euro respektivisht 3,233.20 euro ma lire. Andaj shpresojmë qe OSHP do anuloj vendimin mbi Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit te AK dhe do ta dërgojë lenden ne rivlerësim, për te arritur – kthye zbatimin e ligjshmërisë ne tenderin ne fjale.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Komisioni për ekzaminimin , Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve ne kuadër te AK ka ber shkelje te paragrafit 2 dhe 4 te nenit 59 te LPP-se. Ne përputhej me paragrafin 2 te këtij neni Komisioni i Vlerësimit është dashtë me kërkuar me shkrim sqarime lidhur me plotësimin e specifikave teknike te kërkuara me dosjen e tenderit respektivisht pajisja *“Hydrocal 1011 genX P”* karakteristikat e saja. OE NOVAMAT SH.P.K ka paraqitur ne ofertën e vet te gjithë specifikat e pajisjes *“Hydrocal 1011 genX P”* nga te cilat lehtësisht është pare qe janë te plotësuar specifikat teknike te parapara ne **Dosjen e tenderit ne pjesën specifikimin teknik pika 2.1 ku i paraqet te dhënat teknike te pajisjes.**

Paragrafit 2 i nenit 59 te LPP-se parasheh si ne vijim :

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Obligimi ligjor i shprehur ne mënyrë decideve ne paragrafin 4 te nenit 59 parasheh qe Komisioni për ekzaminimin , Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve ne kuadër te AK te ju përmbahet kushteve te parapara me Njoftimin për Kontrate dhe specifikacionit teknik te parapara me Dosjen e Tenderit qe nënkupton për rastin konkret është dashtë te bëjnë vlerësimin sipas *piken II 1.5 te njoftimit për kontrate theksohet si ne vijim :*

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, ndërsa

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) Sipas specifikimit teknik.

Nëse shikohet Dosja e tenderit ne specifikimin teknik pika 2.1 ku i paraqet te dhënat teknike te pajisjes e thekson si ne vijim :

2.1 Të dhënat teknike të pajisjes

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur parametrat kryesorë teknikë të pajisjes së kërkuar përmes këtij specifikimi, të cilat tregojnë performancën dhe kapacitetin e saj për analizën e gazrave të tretur dhe lagështisë në vajin e transformatorit.

Parametri	Kërkesa	Oferta
Tensioni i furnizimit AC	230 [V] AC	
Frekuenca	50 [Hz]	
Fuqia	40 [W]	
Kutia transportuese	Kuti e fortë plastike	
Mbrojtja	IP67 (kur është e mbyllur) IP20 (kur është duke operuar)	
Vëllimi i mostres së vajit	50 [ml]	
Vëllimi i mostres së gazit	5 [ml] (Buchholz Gas)	
Temperatura e operimit	+5°C deri në +50 °C	
Nxjerrja e matjeve	USB; hardcopy	
Kapaciteti i ruajtjes së matjeve	>20,000 matje	
Diagnostifikimet	Duval's triangle, Roger's ratio, Key Gas & Japanese ETRA	
Madhësia e ekranit	6.5inch (colour touchscreen)	
Pesha	9 [kg]	
Gjuha pajisjes	English	

Paragrafi 4 i nenit 59 e thekson si ne vijim :

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ne rastin konkret AK duket se nuk ja ka bere te qarte Anëtarëve te Komisionit Vlerësues te drejtat dhe obligimet me rastin ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te ofertave, pasi qe komisioni vlerësues nuk e ka pasqyruar faktin **se pajisja** Hydrocal 1011 genX P i **plotëson kriteret dhe kushteve teknike të paraqitura** sipas *piken II 1.5 te njoftimit për kontrate theksohet si ne vijim :*

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, ndërsa

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) **Sipas specifikimit teknik dhe Dosjes se tenderit ne specifikimin teknik pika 2.1 ku i paraqet te dhënat teknike te pajisjes.**

Nga këtu shihet qartazi qe komisioni ka devijuar ne zbatimin e nenit 59 te LPP-se dhe për këtë kërkojmë nga OSHP qe ne përputhje me përgjegjësit ligjore te pranoj Ankesën tonë dhe ta anuloj vendimin mbi anulimin e aktiviteteve te prokurimit dhe ta rivlerësoj dosjen e tenderit te OE NOVAMAT SH.P.K

Andaj duke i pasur parasysh te drejtat dhe obligimet e AK sipas nenit 59 te LPP-se dhe këto fakte relevante juridike te cilat i posedon Dosja e tenderit e dorëzuar nga OE NOVAMAT SH.P.K, ne mendojmë se OE NOVAMAT SH.P.K *eshë i përgjegjshëm dhe mund te shpallet fitues respektivisht te shpërblehet me kontrate për tenderin Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, me nr te prokurimit :*

Nr i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji.

Mos shpërblimi me Kontrate **Ofertën e OE NOVAMAT SH.P.K për tenderin Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, qe ka pasur çmimin me te ulet ne krahasim me ofertën e OE tjetër te dorëzuar ne vlerën prej 66,740.80 euro respektivisht 3,233.20 euro ma lire, tregon se Komisioni i Vlerësimit ne kuadër te AK ka bere shkelje te paragrafit 1.1 te nenit 60 te LPP-se.**

Andaj shpresojmë qe OSHP do anuloi vendimin mbi Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit te AK dhe do ta dërgojë lenden ne rivlerësim, për te arritur – kthye zbatimin e ligjshmërisë ne tenderin ne fjale si dhe ta ruaj pasurin – buxhetin e institucioneve publike.

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
 - 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

AK – Komisioni i Vlerësimit me rastin e eliminimit *te ofertës se OE NOVAMAT SH.P.K duke e theksuar se Autoriteti Kontraktues ne baze te specifikimit teknik ka kërkuar qe pajisja te jete e tipit “Kelman Transport X²”, ndërsa ju keni ofertuar me pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”, e cila nuk i përgjigjet specifikimit teknik, e pastaj AK me publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues” i AK për “Rezultati i aktivitetit të prokurimit” Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu – KOSTT SH.A pas vlerësimit te tenderëve e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se tenderët e dorëzuar nuk janë te përgjegjshëm, shihet se kane vepruar ne kundërshtim edhe me nenin 62 te LPP-se ku trajtohet përfundimi i aktiviteve te prokurimit i cili nuk rezulton me dhënien e kontratës.*

Veprimet e kundërligjshme te AK janë shume qartazi te identifikuara ne këtë Ankese por ketë e plotëson edhe fakti qe ky tender nuk është vlerësuar mbi bazën e dispozitave te LPP-se por te praktikave te funksionimit respektivisht mungesës se aftësive profesionale te stafit, kjo shihet ne vendimin e AK mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtimin te datës 19.02.2025 i cili e thekson si ne vijim :

“Ne si KOSTT posedojmë dhe kemi ne shfrytëzim Pajisjen Kelman Transport X qe nga viti 2006, kurse arsyeja pse eshte kerkuar kjo pajisje (Kelman Transport X2) eshte se kemi një staf te përgatitur (Trajnuar) me këtë pajisje.

- Ne si KOSTT posedojmë dhe kemi në shfrytëzim Pajisjen KELMAN Transport X që nga Viti 2006, kurse arsyeja përse është kërkuar kjo Pajisje (Kelman Transport X2) është se kemi një staf të përgatitur (trajnuar) me këtë pajisje.

Andaj nga dosja e tenderit dhe te dhënat e publikuara për pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”, nga prodhuesi e te qasura për publikun ne faqen zyrtare , mundemi ta konstatojmë se Bazuar në specifikat teknike te listuara më sipër, pajisja më adekuate është HYDROCAL 1011 genX P.

HYDROCAL 1011 genX P përputhet më mirë me specifika te parapara me Dosjes se tenderit ne specifikimin teknik pika 2.1 ku i paraqet te dhënat teknike te pajisjes.

Eshte me rendesi te theksohet ketu po ashtu se:

Sikurse tregohet edhe ne webfaqen e prodhuesit dhe/ apo ne video tutoriale te perdorimit te pajisjes, sic eshte per shembull kjo video:

<https://www.youtube.com/watch?v=AnxR8ureNL8>

porcesi u punes me kete pajisje eshte lehtesisht e realizueshem/ i shpjeguar hap pas hapi dhe tejet praktik ne rutinen e punes se inxhinierëve te cilet do te perdorin keto pajisje.

Nga ana tjetër,

OE NOVAMAT SH.P.K , ne kuadër te mirëkuptimit dhe vullnetit te mire për bashkëpunim do ofroje trajnime pa pagese stafit te AK për ta përdorur pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”.

Andaj AK me rastin e shpalljes se fitues Ofertën e OE NOVAMAT SH.P.K për tenderin Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X² sipas specifikimit teknik, qe ka pasur çmimin me te ulet ne krahasim me ofertën e OE tjetër te dorëzuar ne vlerën prej 66,740.80 euro respektivisht 3,233.20 euro ma lire, kthen zbatimin e dispozitave te LPP-se, kursen buxhetin dhe pajisja HYDROCAL 1011 genX P është zgjedhja më e mirë , për te ngritur – zgjeruar edhe aftësitë profesionale te stafit.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Komisioni për ekzaminimin , Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve ne kuadër te AK ka pasur mundësi, duke shfrytëzuar neni 72 te LPP-se ti sqaroj te gjitha ceshjet lidhur me plotësimin e kërkesave te specifikes teknike te pajisjes dhe ta rrisë vetëdijen profesionale, por si duket nuk i kane pas këto njohuri ligjore andaj edhe kane lëshuar këta gabime per çka lusim dhe shpresojmë qe OSHP do e pranoj Ankesën tone dhe lënda do kthehet ne rivlerësimi dhe ne do shpërblehemi me Kontrate për tenderin :

Nr i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Me qellim te efikasitetit te procesit ne kërkona nga OSHP qe te aprovon Ankesën tone, ta anuloj vendimin e AK mbi anulimin e Aktivitetit te Prokurimit , ta kthej lenden për ne rivlerësim dhe ta obligon AK qe ne rastin konkret te zbatohen dispozitat konkrete ligjore te parapara me LPP-e.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale janë te shumta dhe pas një ekspertize financiare do te caktohen

saktë . Vlen te theksohen disa shpenzime te bëra për veprimet e kompanisë ne kontraktimin për angazhim te stafit dhe mjeteve shtese për këtë tender , atëherë konsiderojmë qe kemi humbje te mëdha materiale, prandaj inkurajojmë OSHP-en qe te aprovoj ankesën tone.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- Dokumenti 1: B05 Njoftim per Kontrat
- Dokumenti 2: B12 Proces verbali i hapjes
- Dokumenti 3: B58 Njoftim mbi Vendimin
- Dokumenti 4: Kërkesë për rishqyrtim Novamat
- Dokumenti 5: FO-PR-033 Njoftim per pezullim
- Dokumenti 6: Specifikimi Teknik, Manuali HYDROCAL 1011 genX P (dorezuar nga Novamat shpk)
- Dokumenti 7: Specifikimi Teknik, GE Kelman Transport X2 DGA Tech Data Sheet(dorezuar nga grupi i OE ELPROJEKT SH.P.K ; ITS GROUP SH.P.K
- Dokumenti 8: Vendim-përgjegje ndaj kërkesës

Dokumenti 1: B05 Njoftim per Kontrat

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

LISTA E DOKUMENTEVE (DËSHMIVE) TË BASHKANGJITURA

Dokumenti Nr. 1 B05 Njoftim per Kontrat

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ **PUNË**

☒ **FURNIZIM**

☐ **SHËRBIME**

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 05.12.2024

Nr i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.		
Adresa Postare: Isa Boletini 39		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: 10000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Bujar Sejdiu +383(0)38/501-301 ext:206 Departamenti i Prokurimit, +383(0)38/501-301 ext:150,151,030,201,069		Telefoni: +383 38501301150
Email: Bujar.Sejdiu@kostt.com prokurimi@kostt.com		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://kostt.com/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit <i>(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)</i>		
<input type="checkbox"/> Punë	<input checked="" type="checkbox"/> Furnizime	<input type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input checked="" type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit Sipas specifikimit teknik		
II.1.3) Njoftimi përfshinë Krijimin e kontratës publike kornizë <input type="checkbox"/>		
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet): Kontrate publike kornizë me një operator <input type="checkbox"/> Kontrate publike kornizë me disa operator <input type="checkbox"/> Ekzekutimi i kontratës: Thirrje/Porosi <input type="checkbox"/> Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë <input type="checkbox"/> Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj		
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2 sipas specifikimit teknik		

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**31680000-6****II.1.7) Variantet pranohen**Po ☐ Jo ☒**II.1.8) Ndarja në Pjesë**Po ☐ Jo ☒*Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)*☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)**

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00****II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS****Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)**
Sipas specifikimit teknik**II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM**Kohëzgjatja në muaj **12** apo ditë (nga dhënia e kontratës)

apo

Fillimi

Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN****III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**Po ☒ Jo ☐*Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit* EUR ose **10% për kohëzgjatjen e periudhës prej +30 dite me shume se afati i realizimit** % e vlerës së kontratës**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):****III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

<p>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</p> <p>Deklarata nën betim</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Deklarata e nënshkruar nën betim në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-92. Të gjithë anëtarët e grupit duhet të dorëzojnë deklaratën e nënshkruar nën betim</p>
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>Certifikata e Regjistrimit të biznesit, se bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare</p> <p>Certifikata e Regjistrimit për TVSH</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Kopja e Certifikatës se Regjistrimit të biznesit,, se bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare</p> <p>Kopja e Certifikatës e Regjistrimit për TVSH</p>
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>Deklaratë mbi specifikimet teknike</p> <p>Ofertuesi të prezantoj një listë të kontratave të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Vlera minimale totale e kontratave të realizuara të prezantuara në listë duhet të jetë 80,000.00€. Në rast ofertimi si Grupit i OE, lideri i grupit duhet të përmbush 51% të vlerës së përcaktuar minimale.</p> <p>Vlerësimi i Ofertës teknike të OE, lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat teknike të kërkuara në dokumentin e Specifikimit teknik</p> <p>Deklaratë e mbi garancionin e furnizimeve për afatin prej 12 muaj</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Deklarata e nënshkruar dhe vulosur mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik</p> <p>Ofertuesi të dorëzoj Një listë të kontratave të realizuara, duke cekur së paku shumën, datën si dhe pranuesin. Kësaj liste të kontratave duhet t'i bashkëngjiten si dëshmi 1. Kur kontrata është realizuar për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, si dëshmi e realizimit shërben kopja e certifikatës (raporti i pranimit apo referenca), të lëshuar ose të bashkë-nënshkruar nga autoriteti publik. Të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar, datën e realizimit, dhe aktivitetet e realizuara. 2. Kur kontrata është realizuar për një autoritet privat, si dëshmi e realizimit shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga realizuesi i kontratës dhe të bashkë-nënshkruar nga autoriteti privat. Të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar, datën e realizimit, dhe aktivitetet e realizuara.</p> <p>Ofertuesi të dorëzoj si dëshmi ofertë teknike, ku precizohen saktë produktet e ofertuara me të dhënat teknike</p> <p>Ofertuesi të dorëzoj si dëshmi Deklaratë të nënshkruar dhe vulosur mbi garancionin e furnizimeve dhe punëve për afatin prej 12 muaj pas Pranimit teknik, me titull dhe nr. të prokurimit të këtij projekti</p>

Katalogët për produktet me të cilat ofertoni Vlerësimi i Ofertës teknike të OE, lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat teknike të kërkuara në dokumentin e Specifikimit teknik	Ofertuesi të dorëzoj si dëshmi Katalogun për produktet e ofertuara, ku precizohen saktë karakteristikat e tyre teknike. Ofertuesi të dorëzoj si dëshmi ofertë teknike me të dhënat teknike të kërkuara në specifikimin teknik.
Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar prej prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar për pajisjet përkatëse Kelman Transport X2	Autorizimi nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar, me të dhënat që mund të verifikohen.

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar</p> <p><i>Nëse po</i>, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse</p>
<p>III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur
<input type="checkbox"/> E kufizuar
<input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata
<input type="checkbox"/> Kuotim i Çmimit
<p>IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (<i>procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata</i>)</p> <p>Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të riekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij riekzaminimi janë:</p>
<p>IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (<i>procedurë konkurruese me negociata</i>)</p> <p>Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar</p> <p>Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p>
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:
IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ Çmimi më i ulët

ose

☐ Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i

i

Po ☐ Jo ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:

data 27.12.2024 koha 13:00:00 vendi përmes e-prokurimit

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

☐ Po ☒ Jo

Nëse po, jep arsytim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **2000**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **90** apo muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **60** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 27.12.2024 koha 13:00:00 vendi KOSTT

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

LISTA E DOKUMENTEVE (DËSHMIVE) TË BASHKANGJITURA

Dokumenti Nr. 2 B12 Proces verbali i hapjes

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	KOSTT-24-12871-1-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	KOSTT023/17-24-85-121		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
27.12.2024	27.12.2024, 13:00:00	27.12.2024, 13:00:00	KOSTT	2

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	NOVAMAT sh.p.k. Rruga "Ismail Qemali" Samos Tower, No. 41. 1001. Tirane, Shqiperi	Q-02024/427	Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2	PO	56560.00	66740.80	JO
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik ELPROJEKT SH.P.K.; ITS GROUP SH.P.K. Rr.Naim Syla nr.31. 10000. PRISHTINE	ELP-271224	Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2	PO	59300.00	69974.00	JO

Komente nga përfaqësuesit e pranishëm


Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:

Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
Merita Zharku		27.12.2024
Diedonë Breca		27.12.2024

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Bujar Sejdiu



* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

LISTA E DOKUMENTEVE (DËSHMIVE) TË BASHKANGJITURA

Dokumenti Nr. 3 B58 Njoftim mbi Vendimin

"Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT" SH.A.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 21.4 të Rregullores së Prokurimit Publik 001-2024

Data: 07.02.2025

Titulli i kontratës: Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së "Kelman Transport X2"

Nr. i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr. i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave €
1.	"NOVAMAT" sh.p.k, Rruga "Ismail Qemali" Samos Tower, No. 41, 1001, Tirane, Shqipëri	66,740.80
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik ELPROJEKT SH.P.K.; ITS GROUP SH.P.K., Rr.Naim Syla nr.31, 10000, Prishtinë	69,974.00

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A. pas vlerësimit të tenderëve e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se tenderët e dorëzuar nuk janë të përgjegjshëm.

Me respekt,

Bujar Sejdiu

Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Data: 07.02.2025

Nga: **Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu- KOSTT" SH.A., Isa Boletini 39 10000 Prishtinë**

Për: **"NOVAMAT" sh.p.k, Rruga "Ismail Qemali" Samos Tower, No. 41, 1001, Tirane, Shqipëri**

Titulli: **Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së 'Kelman Transport X2'**

Nr i prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr. i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Te nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- **Autoriteti Kontraktues në bazë të specifikimit teknik ka kërkuar që pajisja të jetë e tipit "Kelman Transport X² ", ndërsa ju keni ofertuar me pajisjen "Hydrocal 1011 genX P", e cila nuk i përgjigjet specifikimit teknik.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Bujar Sejdiu

Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Data: 07.02.2025

Nga: **Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu- KOSTT" SH.A., Isa Boletini 39 10000 Prishtinë**

Për: **Grup i Operatorëve Ekonomik ELPROJEKT SH.P.K.; ITS GROUP SH.P.K., Prishtinë**

Titulli: **Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2**

Nr i prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr. i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Te nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

1. A.K. në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar :
Kërkesa:

- **Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar prej prodhuesit ose përfaqësuesit te autorizuar për pajisjet përkatëse Kelman Transport X2.**

Dëshmia e kërkuar dokumentare nga Operatori Ekonomik:

- **Autorizimi nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar, me te dhënat qe mund te verifikohen Ndërsa O.E. ka dorëzuar Autorizimin pa të dhënat ku A.K. KOSTT mund të verifikonte Autorizimin në fjalë.**

2. O.E. nuk ka referenca lidhur me kontrata të ngjashme sipas kërkesës se Dosje se tenderit

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Bujar Sejdiu

Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

LISTA E DOKUMENTEVE (DËSHMIVE) TË BASHKANGJITURA

Dokumenti Nr. 4 Kërkesë për rishqyrtim Novamat

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Isa Boletini 39

Qyteti: PRISHTINË

Kodi Postar: 10000

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	KOSTT-24-12871-1-2-1
Nr i brendshëm	KOSTT023/17-24-85-121

Sa i përket tenderit për

Furnizimi me Pajisjen për Analiza të DGA-së Kelman Transport X2

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

NOVAMAT shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Ismali Qemali" Pallati Samos Tower, Kati i 8të, Nr. 41,

(Adresa)

Tirana

1001

(Vendi)

+355 44 505 180

(Kodi postar)

n/a

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mehmet KRASNIQI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@novamat.al

(Adresa elektronike)

11.02.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

06.12.2024..... Njoftimi për kontratë
27.12.2024 Data e hapjes së tenderit
07.02.2025..... Njoftimi mbi Vendimin e AK
07.02.2025 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik (Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 i datës 21 Janar 2016) dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

Neni 1, Qellimi

Neni 28, Specifikimet Teknike

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Përmes sistemit të prokurimit publik, në datë **06.12.2024** jemi njohur me procedurën tenderike të sipër-cituar.

Si palë e interesuar në këtë procedurë kemi filluar menjëherë punën për përgatitjen e dosjes tenderike.

Kështu, në datën 27.12.2024 kemi mundur të prezantojmë pranë AK propozimin tonë teknik dhe financiar për këtë procedurë.

Nga procesverbali i hapjes së kesaj lende (shiko dokumentin bashkëngjitur) konstatojmë se në këtë procedurë, oferta jone është renditur e para mes 2 ofertave të dorëzuara në total për këtë procedurë.

Nderkohe në datë 07.02.2025 përmes sistemit të E-Prokurimit na është komunikuar dokumenti **“B58-Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues”** (shiko në attachment).

Përmes këtij dokumenti na bëhet me dije:

“Rezultati i aktivitetit të prokurimit”

Oper. Sistemi, Trans.dhe Tregu – KOSTT SH.A pas vlerësimit të tenderëve e anulon aktivitetin e prokurimit për arsye se tenderet e dorëzuara nuk janë të përgjegjshëm.

Po ashtu, A.K na vendos në dispozicion përmes E-Prokurimi dokumentin **“Leter standarde për tenderuesin e eliminuar”** (shiko dokumentin në attachment).

Ne kete dokument, AK na ben me dije si me poshte vijon:

Tenderi juaj eshte vleresuar me kujdes sipas kushteve dhe kerkesave te dhena ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojme se jeni eliminuar per shkak te arsyeve ne vijim:

- *Autoriteti Kontraktues ne baze te specifikimit teknik ka kerkuar qe pajoisja te jete e tipit “Kelman Transport X²”, ndersa ju keni ofertuar me pajisjen “Hydrocal 1011 genX P”, e cila nuk i pergjigjet specifikimit teknik.*

Duke mos u pajtuar me kete vendim e AK-se si edhe duke u bazuar ne te drejten qe parasheh Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, paraqitet sot kjo Kerkerse per Rishqyrtim.

Arsyetimin dhe argumentat tona i mbeshetitim ne fakte si me poshte vijon:

Ceshtja e pare dhe me e rendesishme eshte fakti se, ashtu sikurse edhe Ligji i Prokurimit Publik ne Republiken e Kosoves parasheh, qellimi primar i procesit te prokurimit & ligjeve/ neneve/ direktivave dhe dispozivate perkatese ligjore eshte garantimi dhe sigurimi i realizimit te nje procesi efikas, transparent, te drejte, te paanshem dhe me integritet te procesit te tenderimit ne teresi.

Me arsyetimin e prezantuar nga AK mbi anulimin e ofertes sone, konstatojme ne fakt se AK ka shkelur LPP që në nenin e parë te saj.

Keshtu, ngritja e nje pretendimi te tille nga AK sikurse eshte arsyetimi i dhene “Oferta juaj anulohet se ju keni ofruar Hydrocal dhe jo Kelman sic e kerkojme ne”, eshte joligjore.

Te nderuar Zoterinj te AK, vini re ju lutem se Ligji i Prokurimit Publik qarte dhe sakte orienton se si do duhet te behet perpilimi i dosjes se tenderit, i specifikimeve teknike dhe analizimi i tyre.

Ne Nenin 28 te LPP, pika 6 shprehimisht thuhet:

“6.Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluar duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.”
(shiko screenshot me poshte shkeputur nga LPP.)

Neni 28 Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do të parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyrë sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.
2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.
3. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohej sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.
4. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.
5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohej nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.
6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluar duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

Pra, ofrimi i produkteve & shërbimeve ekuivalente duke plotësuar kërkesat e definuara në specifikimin teknik të DST, nuk i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues të refuzojë tenderin me pretendimin se produkti i ofruar nuk përputhet me specifikimin sikurse është formuluar në DST.

Sjellim në vëmendje të AK- se këtij faktin se sikurse është deshmuar nga ana jone përmes dokumentacionit teknik & deklaratave përkatëse të dorëzuar në DST gjatë fazës së tenderimit, produkti i ofruar nga ne është në përputhje me kërkesat teknike të AK të përcaktuara në Dosjen e tenderit.

Ndaj dhe vlerësojmë se anulimi i ofertës sone nga kjo procedurë është jo ligjore dhe bie në kundërshtim me LPP.

Nga ana tjetër, duke ditur klauzolen e LPP i cili i lejon Autoriteteve Kontraktuese përpilimin e specifikimeve teknike eksplicite apo me referime të vecanta VETEM NE KUSHTE TE JASHTEZAKONSHME, duke prezumuar këtë faktin se një produkt identik nuk mund të gjendet në treg apo se s'mund të ketë prodhues të tjerë që mund të ofertojnë produktin apo shërbimin për të cilin AK ka nevojë (Fjala këtë është për pikën 7 të Nenit 28 të LPP:

“7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjinë të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”

Natyrshëm ngrihet pyetja:

Për çfarë arsye Autoriteti Kontraktues e anulon ofertën tonë me pretendimin që nuk është ofruar Kelman Transport X² ?

Për sa kohë që tregu është i hapur dhe ofron një varietet të mundësive dhe zgjidhjeve teknike për të njëjtin produkt dhe në kushtet kur zgjidhjet ekuivalente janë po ashtu një opsion shumë i mirë i propozimit teknik dhe financiar (sikurse është oferta jonë në rastin konkret), atëherë për çfarë arsye Autoriteti Kontraktues nuk merr në konsideratë propozimin tonë dhe madje e anulon këtë propozim ndonëse teknikisht është në përputhje të plotë me DST dhe financiarisht është oferta më e ulët?

Po ashtu një tjetër pyetje që parashtrohet për AK është:

Në rast se nga ana Autoritetit Kontraktues është dashur me insistim që operatorët ekonomikë të ofrojnë produktin “Kelman Transport X²” për çfarë arsye ky AK ka proceduar me këtë lende si “Furnizim/ Procedura e Hapur” kur në fakt mund të operonte për blerjen e produkteve të nevojshme përmes blerjeve një-burimore (përdorimi i kontratave një burimore) sikurse e parasheh edhe ligji i Prokurimit Publik për rastet e “jashtëzakonshme”?

Natyrisht, ky nuk është rasti, pasi që në këtë procedurë prokurohet blerja e një pajisjeje për testimin e gazit të tretur dhe matjen e lageshtisë, pajisje kjo e cila në rastin e produktit të propozuar nga ne ofron mundësive e dedektimit dhe matjeve të 11 gazrave të ndryshme (jo vetëm 8 gazrave sikurse kërkohej nga AK në këtë DST, pra duke ofruar realisht më shumë nga sa kërkohej).

Në atë rast AK do kishte mundur të evitonte njëkohësisht edhe humbjen e kohës së operatorëve ekonomikë të tjerë (kohen tonë në këtë rast) dhe të gjithë kostot që lindin gjatë përgatitjes në mënyrë profesionale të një dosje tenderike.

Kështu, bazuar në sa më sipër në i drejtohem AK- se me këtë Kerkese për Rishqyrtim duke kërkuar:

